

Në bazë të nenit 23 paragrafit (7) të Ligjit për Arsimin e Mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 229/20 dhe 78/25), ministri i Arsimit dhe Shkencës solli

KALENDAR

PËR ORGANIZIMIN DHE PUNËN E SHKOLLËS SË MESME PUBLIKE NË VITIN SHKOLLOR 2024/2025

Neni 1

Me këtë kalendar përcaktohet organizimi dhe puna e shkollave të mesme publike në përputhje me njësitë programore në vitin shkollor: gjysëmvjetorin, format e tjera të veprimtarisë edukativo-arsimore dhe pushimet e nxënësve në vitin shkollor 2024/2025.

Neni 2

Viti shkollor në shkollat e mesme publike fillon më 1 shtator 2024, ndërsa përfundon më 31 gusht 2025.

Viti shkollor fillon më 2 shtator 2024 dhe përfundon më 10 qershor 2025, përveç nxënësve në vitin e fundit të arsimit të mesëm - gjimnaz, arsimit profesional me kohëzgjatje katërvjeçare dhe trevjeçare, arsimit të artit dhe arsimit të mesëm profesional për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, për të cilët mësimi i rregullt përfundon më 16 maj 2025.

Neni 3

Vitin mësimor e përbëjnë dy gjysëmvjetore - gjysëmvjetori I dhe gjysëmvjetori II.
Gjysëmvjetori i parë fillon më 2 shtator 2024 dhe përfundon më 31 dhjetor 2024.
Gjysëmvjetori i dytë fillon më 20 janar 2025 dhe përfundon më 10 qershor 2025.

Neni 4

Gjatë vitit shkollor, nxënësit shfrytëzojnë pushim dimëror dhe veror.
Pushimi dimëror fillon më 1 janar 2025 dhe përfundon më 19 janar 2025.
Pushimi veror fillon më 11 qershor 2025 dhe përfundon më 31 gusht 2025.

Neni 5

Për nxënësit në vitet e fundit të arsimit të mesëm të cilët do t'i nënshtrohen provimit të maturës shtetërore, maturës shkollore ose provimit përfundimtar në afatin e provimeve të qershorit, shkollat e mesme publike prej më 19 maj deri më 30 maj 2025 organizojnë mësim përgatitor, konsultime dhe forma të tjera të ndihmës për nxënësit të cilët duhet t'i nënshtrohen provimeve interne dhe përfundimtare të maturës.

Për nxënësit nga paragrafi 1 i këtij neni, shkollat e mesme publike gjatë periudhës prej më 19 maj deri më 25 maj 2025 organizojnë mësim përgatitor, konsultime dhe forma të tjera të ndihmës për nxënësit që duhet t'i nënshtrohen provimeve përmirësuese, provimeve të vitit dhe provimeve shtesë.

Për nxënësit nga paragrafi 2 i këtij neni, nënshtrimi i provimeve përmirësuese, provimeve të vitit dhe provimeve plotësuese në afatin e provimeve të majit do të organizohen prej 19 maj deri më 30 maj 2025.

Për nxënësit në vitet e fundit të arsimit të mesëm të cilët do t'i nënshtrohen provimit të maturës shtetërore, provimit të maturës shkollore ose provimit përfundimtar në afatin e provimeve të gushtit,

shkollat e mesme publike prej 16 qershori deri më 25 qershor 2025 do të organizojnë mësim përgatitor, konsultime dhe forma të tjera të ndihmës për nxënësit të cilët duhet t'i nënshtrohen provimeve përmirësuese, provimeve të viti dhe provime shtesë.

Për nxënësit nga paragrafi 4 i këtij neni, nënshtrimi i provimeve plotësuese, provimeve të vitit, provimeve plotësuese dhe provimeve për përparim më të shpejtë në afatin e provimeve të qershorit do të organizohet prej më 16 qershori deri më 25 qershor 2025.

Shkollat e mesme publike, prej më 12 qershor deri më 25 qershor 2025 dhe prej më 11 gusht deri më 20 gusht 2025, për nxënësit e vitit të parë, të dytë dhe të tretë organizojnë mësim përgatitor, konsultime dhe forma të tjera të ndihmës për nxënësit të cilët duhet t'i nënshtrohen provimeve përmirësuese, provimeve të vitit, provimeve plotësuese dhe provime për përparim më të shpejtë.

Për nxënësit nga paragrafi 6 i këtij neni, nënshtrimi i provimeve përmirësuese, provimeve të vitit, provimeve plotësuese dhe provimeve për përparim më të shpejtë në sesionin e provimeve të qershorit do të organizohet prej më 12 qershor deri më 25 qershor 2025, ndërsa në sesionin e provimeve të gushtit do të organizohet prej më 11 gusht deri më 20 gusht 2025.

Neni 6

Provimet eksterne për maturën shtetërore në arsimin e mesëm- gjimnaz dhe arsimin profesional katërvjeçar në afatin e provimeve të qershorit realizohen në terminet e mëposhtme

- gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi turke, gjegjësisht gjuhë dhe letërsi serbe më 31 maj 2025, duke filluar nga ora 10:00;

- gjuhë angleze, gjuhë frënge, gjuhë gjermane, gjuhë ruse, gjuhë italiane gjegjësisht matematikë më 11 qershor 2025, duke filluar nga ora 10:00;

- në terminin shtesë, gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi turke. gjegjësisht gjuhë dhe letërsi serbe më 30 qershor 2025, duke filluar nga ora 10:00;

- në terminin shtesë, gjuhë angleze, gjuhë frënge, gjuhë gjermane, gjuhë ruse, gjuhë italiane, gjegjësisht matematikë më 1 korrik 2025, duke filluar nga ora 10:00.

Për nxënësit nga paragrafi 1 i këtij neni, të cilët në afatin e provimeve të qershorit nuk i janë nënshtruar një pjesë ose të gjitha provimeve të maturës shtetërore në arsimin e mesëm - gjimnaz dhe arsimin profesional katërvjeçar ose për arsye të justifikuara nuk i janë nënshtruar provimeve të maturës shtetërore ose një pjesë të provimeve të maturës shtetërore në arsimin e mesëm - gjimnaz dhe arsimit profesional katërvjeçar në afatin e provimeve të qershorit, organizohet afat i dytë në gusht në terminet e mëposhtme:

- gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi turke gjegjësisht gjuhë dhe letërsi serbe më 12 gusht 2025 duke filluar nga ora 10:00;

- gjuhë angleze, frënge, gjermane, ruse, italiane ose matematikë më 14 gusht 2025, duke filluar nga ora 10:00.

Provimet eksterne për provimin e maturës shtetërore në arsimin e artit në afatin e provimeve të qershorit realizohen në terminet e mëposhtme:

- gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi turke, gjegjësisht gjuhë dhe letërsi serbe më 31 maj 2025 duke filluar nga ora 10:00;

- gjuhë angleze, gjuhë frënge, gjuhë gjermane, gjuhë ruse, gjuhë italiane, filozofi, gjegjësisht estetikë më 11 qershor 2025, duke filluar nga ora 10:00;

- në terminin shtesë, gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi turke ose gjuhë dhe letërsi serbe më 30 qershor 2025 duke filluar nga ora 10:00;

- në terminin shtesë, gjuhë angleze, gjuhë frënge, gjuhë gjermane, gjuhë ruse, gjuhë italiane, filozofi, gjegjësisht estetikë më 1 korrik 2025, duke filluar nga ora 10:00.

Për nxënësit nga paragrafi 3 i këtij neni, të cilët në afatin e provimeve të qershorit nuk i janë nështruar një pjesë ose të gjitha provimeve të maturës shtetërore në arsimin e artit ose për arsyt të justifikuara nuk i janë nështruar provimit të maturës shtetërore ose maturës shtetërore në arsimin e artit në afatin e provimeve të qershorit, organizohet afat i dytë i provimeve në terminet në vazhdim:

- gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi turke, gjegjësisht gjuhë dhe letërsi serbe më 12 gusht 2025, duke filluar në ora 10:00;

- gjuhë angleze, gjuhë frënge, gjuhë gjermane, gjuhë ruse, gjuhë italiane, filozofi, gjegjësisht estetikë më 14 gusht 2025, duke filluar në ora 10:00.

Provimet interne nga pjesa zgjedhore e maturës shtetërore realizohen në terminet e përcaktuara nga komisioni i maturës shkollore me propozim të komisioneve adekuate të lëndëve shkollore, edhe atë:

- në afatin e provimeve të qershorit në periudhën nga 17 qershori deri më 27 qershor 2025;
- në afatin e provimeve të qershorit në periudhë shtesë nga 28 qershori deri më 10 korrik 2025 dhe
- në afatin e provimeve të gushtit në periudhë nga 15 gushti deri më 20 gusht 2025.

Prezantimi dhe mbrojtja e detyrës projektuese për nxënësit e arsimit të mesëm - gjimnaz, arsimit të mesëm profesional dhe arsimit të artit për afatin e provimeve të qershorit realizohen në periudhën prej më 1 prill deri më 15 maj 2025, gjegjësisht për terminet shtesë në afatin e provimeve të qershorit prej më 1 qershor deri më 28 qershor 2025 dhe për afatin e provimeve të gushtit prej më 19 gusht deri më 26 gusht 2025.

Neni 7

Provimi i maturës në arsimin e mesëm - gjimnaz, provimi i maturës në arsimin e artit dhe provimi përfundimtar në arsimin profesional katërvjeçar realizohet në dy afate të provimeve: qershor dhe gusht.

Në afatin e provimeve të qershorit:

- pjesa e detyrueshme (gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjegjësisht gjuhë dhe letërsi turke) më 13 qershor 2025, duke filluar nga ora 10:00.

Në afatin e provimeve të gushtit:

- pjesa e detyrueshme (gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjegjësisht gjuhë dhe letërsi turke) më 15 gusht 2025 duke filluar nga ora 10:00.

Provimi nga pjesa zgjedhore e provimit të maturës shkollore në arsimin e mesëm - gjimnaz dhe arsimin e artit, provimi nga pjesa zgjedhore të provimit përfundimtar në arsimin profesional katërvjeçar dhe detyra projektuese realizohen në terminet e përcaktuara nga komisioni i maturës shkollore me propozim të komisioneve adekuate të lëndëve shkollore, edhe atë:

- në afatin e provimeve të qershorit prej 16 qershori deri më 25 qershor 2025 dhe
- në afatin e provimeve të gushtit prej 15 gushti deri më 20 gusht 2025.

Prezantimi dhe mbrojtja e detyrës së projektit për nxënësit e arsimit të mesëm - gjimnaz, arsimit të mesëm profesional dhe arsimit të artit realizohet në periudhën nga 1 prilli deri më 15 maj 2025 dhe nga 19 gushti deri më 26 gusht 2025.

Neni 8

Provimi përfundimtar në arsimin profesional trevjeçar realizohet në tre afate të provimit edhe atë: qershor, gusht dhe janar.

Në afatin e qershorit:

- gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjegjësisht gjuhë dhe letërsi turke më 13 qershor 2025, duke filluar nga ora 10:00.

Në afatin e gushtit:

- gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjegjësisht gjuhë dhe letërsi turke më 15 gusht 2025, duke filluar nga ora 10:00.

Në afatin e janarit - gjatë pushimeve dimërore të nxënësve.

Puna praktike individuale në arsimin profesional trevjeçar realizohet në terminet e përcaktuara nga komisioni i maturës shkollore me propozim të komisioneve adekuate të lëndëve shkollore.

Neni 9

Puna edukativo-arsimore për nxënësit organizohet gjatë gjithë javës së punës.

Neni 10

Gjatë vitit mësimor në shkollat e mesme publike, në vitin përfundimtar të arsimit realizohen të paktën 164 ditë mësimore, ndërsa për të gjitha vitet e mbetura të arsimit realizohen më së paku 180 ditë mësimore.

Neni 11

Gjatë ditës së shkollës organizohen aktivitete kulturore, sportive dhe manifestime të tjera.

Dita tradicionale e arsimit për anëtarët e komuniteteve të cilët ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase shënohet me organizimin e manifestimeve kulturore dhe manifestimeve të tjera.

Dita e shkollës dhe dita tradicionale e arsimit për anëtarët e komuniteteve të cilët ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, janë ditë mësimore kur zhvillohen programe të veçanta.

Neni 12

Ditët e punës kur zhvillohen ekskursione për nxënësit dhe dita e shkollës janë ditë mësimore kur zhvillohen programe të veçanta.

Për nxënësit të cilët nuk i vizitojnë ekskursionet e nxënësve, shkolla organizon mësim të rregullta konform orarit të orëve të mësimi.

Neni 13

Praktika feriale realizohet në varësi të specifikës së profilit arsimor dhe zhvillohet gjatë pushimeve verore të nxënësve.

Neni 14

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij kalendar, pushon së vlefshmi Kalendar për organizimin e vitit shkollor 2024/2025 në shkollat e mesme publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 164/24, 182/24 dhe 37/25).

Neni 15

Ky kalendar hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr. 13-	Министер за образование
-- maj 2025	и наука, Министре е Arsimit dhe Shkencës
Shkup	проф. д-р Весна Јаневска